



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR INTEGRIME EVROPIANE DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE
DIVIZIONI PËR KOORDINIM TË POLITIKAVE

Raport i Punës

së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Janar-Mars, 2017

Prishtinë, 2017

Ky raport paraqet punën e MAPL-së për periudhën Janar-Mars të vitit 2017.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u koncentruar në katër fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor për vitin 2017.

Raporti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL.

Përmbajta

| | |
|--|----|
| Shkurtesat | 4 |
| Hyrje | 5 |
| Përmbledhje ekzekutive | 6 |
| 1. Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal | 9 |
| 2. Zhvillimi i kornizës ligjore dhe zbatimi i legjislacionit për vetëqeverisje lokale | 10 |
| 3. Rritja e efikasitetit dhe transparencës të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë..... | 13 |
| 4. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale | 15 |
| Administrata dhe financat | 18 |
| Auditimi i brendshëm | 19 |
| Prokurimi..... | 20 |

Shkurtesat

| | |
|--------|--|
| AKK | Asociacioni i Komunave të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BNK | Bashkëpunimi Ndërkufitar |
| DEMOS | Decentralizimi dhe Mbështetja e Komunave |
| DIEKP | Departamenti për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave |
| DIE | Divizioni për Integritime Evropiane |
| DKP | Divizioni për Koordinim të Politikave |
| GIZ | Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim |
| IE | Integritet Evropiane |
| IKAP | Instituti Kosovar për Administratë Publike |
| IPA | Integrimi para anëtarësimit |
| KASH | Korniza Afatsmesme e Shpenzimeve |
| KE | Komisioni Evropian |
| KEVL | Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale |
| KCSF | Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MF | Ministria e Financave |
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit |
| NJDNJK | Njësi për Drejtat e Njeriut në Komuna |
| OSCE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian |
| PKZMSA | Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së |
| RAE | Rom, ashkali dhe egjiptas |
| SVL | Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026 |
| SMP | Sistemi për Menaxhimin e Performancës |
| UNDP | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |
| USAID | Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar |
| ZKM | Zyra e Kryeministrit |

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe planin vjetor të punës për vitin 2017, është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës për periudhën Janar-Mars, 2017. Raporti pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura sipas fushave të planifikuara, që njëherit janë edhe objektivat e planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2017:

- Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal;
- Zhvillimi i kornizës ligjore dhe zbatimi i legjisllacionit për vetëqeverisje lokale;
- Rritja e efikasitetit dhe transparencës të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë;
- Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale.

Raporti bazohet në të dhënat periodike të departamenteve të MAPL-së, përkatësisht:

1. Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal;
2. Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
3. Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
4. Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
5. Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
6. Divizioni për Komunikim dhe Informim;
7. Divizioni i Auditimit të Brendshëm;
8. Divizioni i Prokurimit.

Përmbledhje ekzekutive

Përgjatë periudhës Janar-Mars, 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përmbushur një pjesë të rëndësishme të detyrave të planifikuara nga dokumentet e ndryshme strategjike, të inkuorpuara në Planin e Punës për vitin 2017. Planifikimi i aktiviteteve është bërë edhe në Kornizën e Planit të Punës së MAPL-së për vitin 2017, të bazuar në prioritetet e Strategjisë për Vetëqeverisjen Lokale.

MAPL ka realizuar aktivitetet konform përgjegjësive dhe planifikimeve të bëra, duke përfshirë: monitorimin e komunave, procesin e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale, matjen e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, zhvillimin e transparencës komunale, bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar, koordinimin dhe sigurimin e zbatimit të obligimeve të komunave nga agjenda evropiane, etj.

Gjatë kësaj periudhe (janar – mars, 2017), MAPL ka finalizuar Koncept Dokumentin për zhvillimin ekonomik lokal dhe Koncept Dokumentin për zhvillimin rajonal, janë përgatitur dy dokumente lidhur me rekomandimet për Komisionin e Granteve, si dhe doracakun për ciklin e manaxhimit të projekteve, është përfunduar dhe dorëzuar në komuna.

Sa i përket mbështetjes së komunave në përmirësimin e infrastrukturës nga fondet e MAPL-së për infrastrukturë, MAPL ka ndarë buxhetin për vitin 2017 për financim të projekteve të komunave. Komisioni vlerësues i MAPL-së ka përzgjedhur si të suksesshme 29 projekte të komunave, në vlerën prej 2,282.191.00 euro, ku kanë përfituar 33 komuna.

Në fushën e zhvillimit të kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale, MAPL ka planifikuar 2 koncept-dokumente dhe 2 projektligje. MAPL ka mbajtur një takim me grupin ndër ministror për hartimin e Koncept Dokumentit për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale, si dhe ka finalizuar Koncept Dokumentin për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale. Ka vazhduar edhe vlerësimi i ndikimit të zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje lokale me qëllim përmirësimin e politikave në drejtim të thellimit të demokracisë vendore, janë miratuar vendimet për përcaktimin e zyrtarëve përgjegjës dhe grupeve punuese për hartimin e akteve nënligjore të planifikuara për vitin 2017.

Është themeluar grupi punues për hartimin e Projekt-rregulloren Nr. 02 /2013 për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale. MAPL ka bërë harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, ku janë pranuar gjithsej 23 akte për konsultim paraprak të dërguara nga ministritë e linjës, prej të cilave: Dy (2) Projektligje, Nëntë (9) Projekt-rregullore, Gjashtë (7) Udhëzime Administrative, Pesë (5) Koncept Dokumente. Prej tyre, 19 janë konstatuar se janë në përputhje me legjislacionin bazë për vetëqeverisje lokale.

MAPL përmes mekanizmave të mbikëqyrjes së punës së komunave, gjatë kësaj periudhe ka monitoruar 113 mbledhje të kuvendeve të komunave. Prej tyre 105 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 8 të jashtëzakonshme. MAPL ka hartuar 113 raporte të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave. Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars 2017. Gjithashtu, MAPL ka pranuar gjithsej 494 akte të Komunave, nga 494 akte të

komunave, MAPL ka vlerësuar 172 akte apo 34.8%, ndërsa 322 apo 63.2% i ka proceduar tek Ministritë e linjës. Gjatë procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë, MAPL ka identifikuar 10 shkelje ligjore apo 6% nga totali i akteve të shqyrtuara nga MAPL, për të cilat ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Nga ky numër, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar me ligj vetëm 2 akte apo 20% të tyre. Krahas kësaj, ministritë e linjës kanë identifikuar 6 shkelje ligjore apo 2% nga totali i akteve të shqyrtuara, prej të cilave vetëm 1 apo 16% është rishqyrtuar dhe harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Në total, gjatë periudhës raportuese MAPL dhe Ministritë e linjës kanë identifikuar 16 shkelje ligjore, prej të cilave vetëm 3 janë rishqyrtuar.

Në fushën e koordinimit të politikave, MAPL ka koordinuar aktivitetet brenda dhe jashtë saj, fillimisht është koordinuar procesi rreth hartimit të planit vjetor të punës për Qeveri, planit vjetor të punës për MAPL, është koordinuar procesi po ashtu edhe për hartimin e raportit tremujor të punës për MAPL, për Qeveri, si dhe raporti për zbatimin e vendimeve të punës. MAPL, ka bashkërenduar aktivitetet e saj me donatorë/partneret për sa i përket mbështetjes së tyre për implementimin e aktiviteteve të MAPL-së, si: OSCE, DEMOS, UNDP, BB, GIZ, USAID, etj.

Në fushën e performancës komunale dhe atë të transparencës, MAPL fillimisht ka bërë vlerësimin e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve me qytetarë, është përgatitur databaza elektronike (SIMFK) në të cilën janë sistemuar të gjitha të dhënat e raportuara nga komunat, si dhe është përgatitur sistemi i ri i vlerësimit të performancës së shërbimeve komunale, i cili është në fazën finale dhe është instaluar në serverët të cilët menaxhohen nga Ministria e Administratës Publike. Kurse, me qëllim të zhvillimit të një komunikimi më efikas me publikun dhe njoftimin e publikut për fushë veprimtarinë e saj, ka ndërmarrë veprime për përmirësimin e sistemeve on-line të informacionit dhe transparencës për qytetarë, ku gjatë kësaj periudhe (janar – mars) ka pranuar 7 kërkesa për qasje në dokumente publike, të parashtruar nga: 2 kërkesa nga anëtarë të Kuvendit të Komunës, 3 kërkesa nga organizatat jo qeveritare, si dhe 1 nga gazetarët.

Lidhur me forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale, MAPL ka bërë vlerësimin e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve komunal i përfunduar në 38 komuna, është hartuar plani i trajnimeve për vitin 2017 për MAPL-në dhe komunat, janë përgatitë 2 broshura informative për komunat të publikuara në faqen zyrtare elektronike të MAPL-së, si dhe një informator për përfitimet e përgjithshëm nga trajnimet “10 ide të shkëlqyeshme për trajnimet on-line”. Ndërsa, me qëllim të promovimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut, stafi nga MAPL ka marrë pjesë në grupet punuese ndër ministrorë për qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut.

Në fushën e bashkëpunimit me shoqërinë civile, MAPL ka shpallur thirrjen për projekt-propozime me qëllim të mbështetjes financiare të komunave, institucioneve të tjera dhe organizatave të shoqërisë civile, janë mbështetur financiarisht 31 projekte, prej të cilave 27 OJQ , 2 projekte për komuna dhe 2 projekte për institucione të tjera të administratës publike. Vlera totale për financimin e 31 projekteve kap shumën prej 91,870.00 euro.

Në fushën e integriteteve evropiane janë adresuar obligimet në procesin e liberalizimit të vizave dhe zbatimi i obligimeve të dala nga procesi i MSA-së dhe për këtë qëllim MAPL ka përgatitur matricat me identifikimin e çështjeve të cilat kërkojnë të ndërmerren nga komunat nga procesi i DPSA-së dhe PKZMSA, janë përgatitur planet individuale për 38 komuna nga obligimet e agjendës evropiane për vitin 2017. Sipas raporteve, komunat kanë arritur të përmbushin 78% të aktiviteteve të parapara në fushën e kriterëve politike. Sa i përket kriterëve ekonomike, komunat kanë përmbushur 75% të aktiviteteve të parapara, ndërsa në fushën e standardeve evropiane, komunat kanë realizuar 68% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së kriterëve nga agenda evropiane ka qenë 73%.

MAPL ka shënuar progres edhe në kuadër të zbatimit të programeve për bashkëpunim ndërkufitar, përkatësisht në programet: Kosovë – Shqipëri, Kosovë – Mal i Zi dhe Kosovë Maqedoni. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkombëtar.

MAPL gjatë periudhës janar – mars, 2017 ka hartuar këto raporte: raportin vjetor të punës së MAPL-së (janar – dhjetor, 2016), raportin vjetor të të hyrave vetanake, raporti vjetor i shpenzimeve komunale, analiza e investimeve kapitale, raporti lidhur me planifikimin dhe gjendjen aktuale të stafit në komunat Mitrovica Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq dhe informata lidhur me stafin dhe buxhetin në kategorinë e pagave për vitin 2017 për komunat Mitrovica Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Pastaj, raportet: raporti vjetor i obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – dhjetor 2016, analiza për shkallën e përmbushjes së obligimeve të komunave nga agenda evropiane për periudhën janar - dhjetor 2016, raporti vjetor për fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkombëtar, është hartuar analiza e realizimit të planit të punës së MAPL-së për vitin 2016, është përgatitur fleta informuese e Ministrisë për vitin 2016 dhe është dërguar për publikim në faqen zyrtare të MAPL-së, raporti vjetor i funksionimit të komunave Janar-Dhjetor 2016, përgatitja e propozimeve për Koncept-Dokumentin për çështjen e suspendimit nga marrëdhënia e punës të zyrtarëve publik nga institucionet e Republikës së Kosovës, iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, hartimi i dokumentit të KASH-it për vitin 2018-2020, si dhe identifikimi i aktiviteteve për vitin 2016 - 2017 që dalin nga Plani i Veprimtari të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026

Të dhënat tregojnë se në periudhën janar – mars, 2017 MAPL ka 133 shërbyes civil, prej tyre 72 meshkuj dhe 61 femra. Sa i përket përbërjes etnike, janë: 102 shqiptar, 29 serb dhe 2 turq.

Totali i shpenzimeve për buxhetin e MAPL-së është 270,533.12 ose 5.45%. ndërsa, donacioni deri tani është shpenzuar 6,115.17 ose 6.03 %, si dhe raporti i realizimit të shpenzimeve së bashku me donacion është 5.47 %

Në fushën e auditimit, konform planit vjetor të punës për vitin 2016, ky sektor ka filluar me auditimet e vitit 2016, janë përfunduar dhe proceduar në kohën e paraparë raporti i TM4/2016 dhe Raporti Vjetor i punës së NJAB-it për vitin 2016. Kurse, njësia e prokurimit ka zhvilluar aktivitet e saj. Prej 7 aktiviteteve të prokurimit, 2 janë tender, 2 janë kuotime të çmimeve, si dhe 3 janë kuotime të çmimeve me vlerë minimale (blerje minimale).

1. Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal

Bazuar në objektivat e planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2017, MAPL gjatë periudhës janar – mars, 2017 ka hartuar dhe finalizuar Koncept Dokumentin për zhvillim ekonomik lokal, i cili është dërguar në qeveri për aprovim. Po ashtu, MAPL ka hartuar edhe Koncept dokumentin për zhvillim rajonal, janë mbajtur 2 konsultime publike me komunat dhe OJQ-të. Në këtë rast është realizuar edhe vizita studimore në Slloveni dhe Austri, në mënyrë që grupi punues të njohë më mirë praktikatat e këtyre vendeve sa i përket kësaj fushe. MAPL është në fazën e bashkëpunimit me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe Ministrinë e Integritimit Evropian në mënyrë që dokumenti të jetë i koordinuar me gjithë akterët para dërgimit në Qeveri për aprovim. Sipas opsioneve të dhëna në këtë koncept-dokument, pritet që të krijohet një sistem institucional për zhvillim rajonal si dhe mekanizma përgjegjës për implementimin e këtij procesi.

Janë përgatitur dy dokumente lidhur me rekomandimet për Komisionin e Granteve, një dokument me datën 07 mars 2017 dhe dokumenti tjetër me datën 30 mars 2017. Po ashtu, MAPL ka përgatitur:

- Raportin vjetor për të hyrat vetanake në muajin mars 2017 dhe është dorëzuar për publikim me raportin vjetor monitorimit të komunave;
- Është përgatitur raporti vjetor i shpenzimeve komunale në muajin mars 2017 dhe është dorëzuar për publikim me raportin vjetor monitorimit të komunave;
- Është përgatitur drafti final i analizës për investime kapitale pas komenteve nga Ministria e Financave dhe është proceduar më tej.

Me qëllim të ndihmës së komunave sa i përket planifikimit dhe shpenzimeve të të hyrave vetanake, MAPL ka marrë pjesë në grupin punues me MASHT-in dhe MF-në lidhur me hartimin e rregullores për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional dhe arsimit për të rritur, si dhe është përgatit raporti lidhur me planifikimin dhe gjendjen aktuale të stafit në komunat Mitrovice Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq dhe informata lidhur me stafin dhe buxhetin në kategorinë e pagave për vitin 2017 për komunat Mitrovice Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.

Sa i përket mbështetjes së komunave në përmirësimin e infrastrukturës nga fondet e MAPL-së për infrastrukturë, gjatë kësaj periudhe MAPL në fushën e zhvillimit ekonomik lokal përmes projekteve infrastrukturore, ka ndarë buxhetin për vitin 2017 për financim të projekteve të komunave. Komisioni vlerësues i MAPL-së ka përzgjedhur si të suksesshme 29 projekte të komunave, në vlerën prej 2,282.191.00 euro. Projektet janë mbështetur për shtrirjen e ndriçimit publik në komuna, rrugëve, kanalizim, fusha sportive, objekte shkollore, trotuare etj. Komunat të cilat kanë përfituar projekte nga ky fond janë: Zveçan, Fushë-Kosovë, Obiliq, Malishevë, Zubin Potok, Pejë, Istog, Graçanicë, Ferizaj, Kamenicë, Hani i Elezit, Vushtrri, Graçanicë, Ferizaj, Kamenicë, Hani i Elezit, Vushtrri, Kaçanik, Lipjan, Gjilan, Drenas, Skenderaj, Junik, Gjakovë, Rahovec, Suharekë, Viti, Podujevë, Deçan, Shtërpçë, Shtime, Dragash dhe Kllokot.

Po ashtu, MAPL ka mbështetur komunat në përmirësimin e infrastrukturës nga fondet e MAPL-së për zhvillimin rajonal me rajonal me qëllim të mbështetjes së ri-gjenerimit ekonomik, krijimit të vendeve të punës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonet ekonomike të Kosovës, me ç'rast ka lansuar një fond për projekte kapitale dhe i njëjti fond është ndarë në mënyrë individuale në komuna, i cili në vazhdimësi monitorohet nga divizioni për menaxhimin e zbatimit të projekteve të MAPL-së.

Po ashtu, MAPL ka përgatitur doracakun për ciklin e menaxhimit të projekteve, është përfunduar dhe dorëzuar në komuna. Në periudhën raportuese janë pranuar 76 kërkesa nga komunat sipas thirrjes për aplikim, si dhe 22 kërkesa individuale nga komunat pas përfundimit të thirrjes për propozime. Deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2017 janë vlerësuar 42 kërkesa. MAPL nga fondi i saj për vitin 2016

Janë hartuar dhe aprovuar kërkesat për financimin e projekteve nga fondi i infrastrukturës, është bërë lansimi i thirrjes për propozime për fondet e MAPL-së, janë pranuar 98 kërkesa nga komuna në kuadër të thirrjes së propozimeve, si dhe janë hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e projekteve. Është freskuar fondi i baza e fondit nga MAPL për vitin 2016 me 39 projekte dhe nga fondi i BE-së me 30 projekte, është në funksion sistemi i instranetit dhe janë adresuar kërkesat shtesë të komunave,, si dhe është dizajnuar komponenta e lejeve të ndërtimit e cila pritet të konfirmohet nga MMPH dhe të vihet në funksion.

2. Zhvillimi i kornizës ligjore dhe zbatimi i legjislacionit për vetëqeverisje lokale

Në kuadër të detyrave të planifikuara për vitin 2017 në fushën e zhvillimit të kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale, MAPL ka planifikuar 2 koncept-dokumente dhe 2 projektligje. Në këtë drejtim, MAPL fillimisht ka bërë ndryshim plotësimin e kornizës ligjore për kufijtë administrativ të komunave me ç'rast në bazë të vendimit Nr.02-185/4 dt.14.10.2016 për themelimin e Grupit punues për hartimin e Koncept-Dokumentit për kufijtë administrativ të komunave, është mbajtur takimi i parë i grupit punues dhe është përgatitur drafti i parë i koncept-dokumentit. Ky koncept-dokument ende nuk ka kaluar në fazën konsultimit paraprak dhe publik. Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Mars 2017, MAPL konform detyrave të përcaktuara në Planin Vjetor të Punës ka zhvilluar aktivitetet për hartimin e Projekt-Ligjit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës – Prishtinës. Është mbajtur takimi i parë i grupit punues, ku është shqyrtuar përmbajtja e projektligjit. Janë planifikuar edhe dy takime me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë për Shëndetësi, për të marrë mendimin e tyre lidhur me kompetencat e kryeqytetit në fushën e sigurisë, si dhe kompetencat në fushën e kujdesit dytësor shëndetësor. Në pjesën e parë të muajit prill, planifikohet që ky projektligj të kalojë procedurat e konsultimit publik dhe konsultimit paraprak.

Gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2017, MAPL ka mbajtur një takim me grupin ndër ministror për hartimin e Koncept Dokumentit për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale. Koncept-Dokumenti është finalizuar nga grupi punues, është përgatitur kostoja financiare për ngritjen e akademisë dhe pas finalizimit do të kalojë në konsultim publik dhe konsultim paraprak sipas procedurave të parapara.

Në këtë periudhë raportuese ka vazhduar edhe vlerësimi i ndikimit të zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje lokale me qëllim përmirësimin e politikave në drejtim të thellimit të demokracisë vendore, janë mbajtur 3

takime të grupit punues përgjegjës për hartimin e raportit për vlerësimin ex-post të ligjit për vetëqeverisje lokale. Kurse, për nevoja të identifikimit të problemeve në sistemin e vetëqeverisjes lokale janë zhvilluar 2 takime regjionale me kryesues të kuvendeve të komunave dhe anëtarë të kuvendeve të komunave, është bërë përmbledhja e komenteve nga takimet e mbajtura dhe janë evidencuar propozimet lidhur me nevojat për ndryshimin e këtij ligji të cilat duhet të adresohen gjatë hartimit të politikave paraprake, si dhe është hartuar drafti i parë i raportit për vlerësimin ex-post të këtij ligji. Është bërë identifikimi dhe hartimi i listës së projektligjeve që ndërlidhen me vetëqeverisjen lokale dhe që janë pjesë e Programit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2017, me ç'rast MAPL ka identifikuar 31 projektligje nga programi legjislativ i Qeverisë që ndërlidhen me kompetencat dhe organizimin e vetëqeverisjes lokale, si dhe mandatin e MAPL-së. Përmes shkresës informuese të dërguar në ZKM, është kërkuar që të gjitha projektligjet që ndërlidhen me vetëqeverisjen lokale të dërgohen për konsultim paraprak në MAPL për tu harmonizuar me legjislacionin bazë të vetëqeverisjes lokale. Po ashtu, MAPL ka realizuar edhe këto aktivitete në fushën e zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit, si vijon:

- Lidhur me hartimin e akteve ligjore janë miratuar vendimet për përcaktimin e zyrtarëve përgjegjës dhe grupeve punuese për hartimin e akteve nënligjore të planifikuara për vitin 2017;
- Janë mbajtur dy takime të grupit punues për ndryshim-plotësimin e Projekt Rregullores për hartimin dhe publikim e akteve të komunës. E njëjta rregullore është lansuar në platformën për konsultim publik të Qeverisë si dhe në ueb-faqen e MAPL-së. Pas kalimit të afatit ligjor për konsultim paraprak dhe konsultim publik, grupi punues ka vazhduar me shqyrtimin e komenteve të marra nga ky proces.
- Është themeluar grupi punues për hartimin e Projekt-rregulloren Nr. 02 /2013 për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale. Janë mbajtur 4 takime për draftimin e rregullores. Janë marrë të gjitha komentet nga palët e interesit: komunat, organizatat e huaja të cilat mbështesin këtë proces. MAPL është në fazën përfundimtare të draftimit të kësaj rregullore. Rregullorja ka kaluar fazën e konsultimit publik, ndërsa mbetet të përfundohet konsultimi paraprak.

MAPL në periudhën janar – mars, 2017 ka bërë harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, ku janë pranuar gjithsej 23 akte për konsultim paraprak të dërguara nga ministritë e linjës, prej të cilave: Dy (2) Projektligje, Nëntë (9) Projekt-rregullore, Gjashtë (7) Udhëzime Administrative, Pesë (5) Koncept Dokumente. Prej tyre, 19 janë konstatuar se janë në përputhje me legjislacionin bazë për vetëqeverisje lokale. Ndërkaq, MAPL ka dhënë komente në 4 aktet si në vijim:

- Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, iniciuar nga MF;
- Projekt-Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, iniciuar nga MF;
- Projekt-Rregulloren për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrit, inicuar nga MPB;

- Projekt-Udhëzim Administrativ për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2012 për organizimin, fushëveprimin dhe funksionimin e këshillit për shërbime sociale dhe familjare, iniciuar nga MPMS.

Ndërsa, sa i përket harmonizimit të legjislacionit për vetëqeverisje lokale me atë të BE-së, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë akt ligjor për dhënien e opinionit për sa i përket përmbushjes së standardeve evropiane.

Lidhur me forcimin dhe zbatimin e legjislacionit për vetëqeverisje lokale nga komuna, MAPL përmes mekanizmave të mbikëqyrjes së punës së komunave, gjatë kësaj periudhe ka monitoruar 113 mbledhje të kuvendeve të komunave. Prej tyre 105 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 8 të jashtëzakonshme. MAPL ka hartuar 113 raporte të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave. Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars 2017. Gjithashtu, MAPL ka hartuar raportin tre mujor të funksionimit të Kuvendeve të komunave. Gjatë kësaj periudhe (Janar-Mars 2017), MAPL ka pranuar gjithsej 494 akte të Komunave, nga 494 akte të komunave, MAPL ka vlerësuar 172 akte apo 34.8%, ndërsa 322 apo 63.2% i ka proceduar tek Ministrinë e Linjës. Gjatë procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë, MAPL ka identifikuar 10 shkelje ligjore apo 6% nga totali i akteve të shqyrtuara nga MAPL, për të cilat ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Nga ky numër, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar me ligj vetëm 2 akte apo 20% të tyre. Krahas kësaj, ministrinë e Linjës kanë identifikuar 6 shkelje ligjore apo 2% nga totali i akteve të shqyrtuara, prej të cilave vetëm 1 apo 16% është rishqyrtuar dhe harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Në total, gjatë periudhës raportuese MAPL dhe Ministrinë e Linjës kanë identifikuar 16 shkelje ligjore, prej të cilave vetëm 3 janë rishqyrtuar. Komunat të cilat kanë bërë shkelje ligjore me rastin e aprovimit të akteve nënligjore janë: Graçanicë (1), Glogoc (2), Dragash (2), Rahovec (2), Ferizaj (4), Istog (1), Viti (1), Shtime (1), Suharekë (1). Vendimet e kundërligjshme janë rishqyrtuar nga komunat: Rahovec (1), Istog (1) dhe Ferizaj (1).

Për të adresuar çështjet e identifikuar edhe nga raporti i funksionimit të komunave për periudhën janar-dhjetor 2016, si dhe për të siguruar zbatimin e ligjit në komuna në prag të zgjedhjeve lokale, janë mbajtur 2 takime regjionale me kryesues të kuvendeve dhe anëtarë të kuvendeve të komunave. Gjatë muajit prill, janë të planifikuara edhe 3 takime të tjera me fokus-grupet e komunave të tjera. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese Janar- Mars 2017, është mbajtur takimi i përbashkët me ministrinë e Linjës dhe MAPL-në për shqyrtimin administrativ të akteve komunale. Projekti është mbështetur nga OSBE.

Në fushën e koordinimit të politikave, MAPL ka koordinuar aktivitetet brenda dhe jashtë saj, fillimisht është koordinuar procesi rreth hartimit të planit vjetor të punës për Qeveri, planit vjetor të punës për MAPL, është koordinuar procesi po ashtu edhe për hartimin e raportit tremujor të punës për MAPL, për Qeveri, si dhe raporti për zbatimin e vendimeve të punës. MAPL, ka bashkërenduar aktivitetet e saj me donatorë/partnerët për sa i përket mbështetjes së tyre për implementimin e aktiviteteve të MAPL-së, si: OSCE, DEMOS, UNDP, BB, GIZ, USAID, etj.

MAPL, gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2017 ka bërë koordinimin e procesit rreth hartimit të planit të auditorit për raportim në Ministrinë e Financave, është koordinuar procesi i planit të integruar për auditimin e brendshëm për vitin 2016 me të gjitha njësitë e MAPL-së të cilat janë të involvuara.

Hartimi i planit të integruar për auditimin e brendshëm të MAPL-së për vitin 2016 - pas procesit të koordinimit është finalizuar drafti i planit të integruar për auditimin e brendshëm të MAPL-së për vitin 2016, i cili përmban aktivitetet dhe kohën e realizimit të tyre nga njësitë e MAPL-së. Është hartuar analiza e realizimit të planit të punës së MAPL-së për vitin 2016. Kurse, me qëllim të prezantimit të aktiviteteve kryesore të njësive në MAPL, është përgatitur fleta informuese e Ministrisë për vitin 2016 dhe është dërguar për publikim në faqen zyrtare të MAPL-së. Po ashtu:

- Ka filluar mbledhja e të dhënave për hartimin e manualit për përfshirje të qytetarëve në punë vullnetare, si dhe është finalizuar drafti fillestar;
- Hartimi i raportit vjetor të funksionimit të komunave Janar-Dhjetor 2016
- Përgatitja e propozimeve për Koncept-Dokumentin për çështjen e suspendimit nga marrëdhënia e punës të zyrtarëve publik nga institucionet e Republikës së Kosovës, iniciuar nga Ministria e Drejtësisë
- Hartimi i dokumentit të KASH-it për vitin 2018-2020
- Identifikimi i aktiviteteve për vitin 2016 - 2017 që dalin nga Plani i Veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026

3. Rritja e efikasitetit dhe transparencës të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë

Gjatë periudhës raportuese janar – mars, 2017, MAPL ka bërë vlerësimin e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve me qytetarë, është bërë monitorimi i performancës komunale në ofrimin e shërbimeve është bërë duke u bazuar në metodologjinë standarde për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave komunale. Në muajin janë është bërë monitorimi i procesit të raportimit në komuna sipas një plani të vizitave të realizuar në komuna. Gjatë kësaj periudhe (janar – mars, 2017), MAPL ka zbatuar metodologjinë për standarde, mbledhje, verifikim dhe raportim të të dhënave komunale për vitin 2016. Nga 35 komuna janë pranuar të dhënat e raportuara për performancën e shërbimeve komunale për vitin 2016. Sa u përket komunave me shumicë serbe, pas afatit të përcaktuar zyrtar, deri në këtë periudhë ka raportuar vetëm Komuna e Leposaviqit. Është përgatitur databaza elektronike (SIMFK) në të cilën janë sistemuar të gjitha të dhënat e raportuara nga komunat. Është bërë përpunimi i të dhënave komunale dhe sistemimi i tyre në databazën finale të SMPK-së, ndërsa në proces është hartimi i dokumentit fillestar të raportit të performancës së komunave për vitin 2016. Komunat të cilat nuk kanë raportuar janë: Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore. Po ashtu, është përgatitur sistemi i ri i vlerësimit të performancës së shërbimeve komunale, i cili është në fazën finale dhe është instaluar në serverët të cilët menaxhohen nga Ministria e Administratës Publike.

Progres në këtë periudhë është vërejtur edhe në fushën e përmirësimit të sistemit online të informacionit dhe transparencën me qytetarë. Në këtë rast, MAPL me qëllim të zhvillimit të një komunikimi më efikas me publikun dhe njoftimin e publikut për fushë veprimtarinë e saj, ka ndër marrë veprime për përmirësimin e sistemeve on-line të informacionit dhe transparencës për qytetarë. Përmes projektit DEMOS, është kontraktuar kompania përgjegjëse për zhvillimin e faqeve zyrtare elektronike të komunave,

sistemin e teleprezencës për monitorim të kuvendeve të komunave, si dhe ri-dizajnimin e faqes zyrtare elektronike të MAPL-së. Për nevoja të procesit është themeluar Grupi mbështetës për hartimin e përmbajtjes së faqes zyrtare elektronike të MAPL-së, krijimin e profilit zyrtar të MAPL-së në rrjetin social facebook, si dhe ofrimin e propozimeve shtesë për finalizimin e faqeve zyrtare elektronike të komunave. Grupi ka finalizuar projekt-propozimin për ueb-faqen e MAPL-së, profilin zyrtar në facebook, si dhe ka propozuar platformën e komunikimit për çështjet e sigurisë në bashkësi, e cila do të jetë pjesë e ueb-faqeve zyrtare të komunave. Gjithashtu është propozuar edhe platforma për komunikim publik me qytetarë, e cila do mundësoj parashtrimin e pyetjeve online nga qytetarët dhe njëkohësisht marrjen e përgjigjeve përmes platformës së veçantë të integruar në ueb-faqen e MAPL-së. Veç kësaj, Grupi Punues ka mbajtur 3 takime konsultative me kompaninë përgjegjëse për sqarimin e të gjitha aplikacioneve të propozuara përbrenda ueb-faqeve komunale dhe ueb-faqes së MAPL-së. Kompania përgjegjëse është në fazën e përmbylljes së programimit të faqeve zyrtare elektronike konform propozimeve të palëve të përfshira në këtë proces. Po ashtu, MAPL gjatë kësaj periudhe (janar – mars) ka pranuar 7 kërkesa për qasje në dokumente publike, të parashtruar nga:

- 2 kërkesa nga anëtarë të Kuvendit të Komunës;
- 3 kërkesa nga organizatat jo qeveritare;
- 1 nga gazetarët.

Është e verifikuar lista e personave kontaktues për qasje në dokumente publike në komuna për 2017, të gjitha përgjigjet janë ofruar sipas afatit kohor të përcaktuar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, është hartuar raporti për qasje në dokumente publike nga komuna periudhën janar -dhjetor 2016, është organizuar takimi nga zyra e informimit pranë ZKM ne mbështetje të MAPL dhe OSBE-së, si dhe janë zhvilluar dhe janë koordinuar edhe aktivitetet për organizmin e takimeve të ndryshme, si dhe aktivitetet:

- Publikimi i rregulloreve në ueb-faqet zyrtare të komunave, rregullorja për transparencë;
- Publikim i vendimeve në ueb-faqe zyrtare të komunave;
- Publikimi i njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal;
- Njoftime për debate publike me qytetarët;
- Publikimi i procesverbaleve;
- Publikimi i buxheti nga komunat planin e buxhetit, korniza afatmesme;
- Publikimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare;
- Vendimet e kryetarit Transparenca në prokurim;
- Plani i Veprimit për transparencë;
- Publikimi planit zhvillimor urbanistik si strategji.

Gjatë kësaj periudhe është bërë vlerësimi i Planit të veprimit për transparencë të cilat i kanë dërguar komunat dhe është hartuar raportit i transparencës.

4. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale

Lidhur me forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale, ka realizuar këto aktivitete, si vijon:

1. Raporti i vlerësimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve komunal i përfunduar në 38 komuna;
2. Në bashkëpunim me UNDP-në është bërë vlerësimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve për zyrtarët komunal;
3. Është hartuar plani i trajnimeve për vitin 2017 për MAPL-në dhe komunat;
4. Për fushën e ngritjes së kapaciteteve, janë përgatitë 2 broshura informative për komunat të publikuara në faqen zyrtare elektronike të MAPL-së. Veç kësaj është përgatitur një informator për përfitimet e përgjithshëm nga trajnimet “10 ide të shkëlqyeshme për trajnimet on-line”;
5. Është finalizuar analiza për mbajtjen e trajnimeve në komuna.

Me qëllim të finalizimit të këtyre aktiviteteve, MAPL ka bashkëpunuar me partnerë, me ç’rast janë mbajtur takime individuale me donatorët: USAID/AKT, OSBE, UNDP, nga të cilat është siguruar mbështetja në organizimin e 3 projekteve për trajnimin e zyrtarëve komunal, përfshirë: kryesuesit e kuvendeve të komunave, anëtarët e kuvendeve të komunave, zyrtarët ligjor dhe zyrtarët për integritet evropian në komuna. Gjithashtu, është proceduar kërkesa tek Departamentet dhe Njësitë Organizative të MAPL-së për të identifikuar nevojat për aplikim në TAIEX, si dhe është proceduar kërkesa zyrtare në Komisionin Evropian lidhur me marrjen e konfirmimit për organizimin e aktivitetit “Misioni i ekspertëve në ngritjen e kapaciteteve të MAPL-së” me referencë 63613. Ky aktivitet parashihet të mbahet në javën e fundit të muajit prill 2017.

Fusha e të drejtave të njeriut ka pasur një rëndësi të veçantë në këtë periudhë raportuese, me ç’rast MAPL me qëllim të promovimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut ka hartuar pyetësorin dhe të njëjtin e ka dërguar në komuna, pastaj janë mbledhur të dhënat nga pyetësorët, janë analizuar dhe është finalizuar raporti për të drejtat e njeriut. Po ashtu, MAPL ka marr pjesë në grupet punuese ndër ministrore për qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut, si:

- Grupi punues për të drejtat e fëmijëve;
- Grupi Punues për parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve;
- Grupi Punues për të drejtat e komunitetit LGBTI;
- Grupi Punues për parandalimin e trafikimit të njerëzve;
- Grupi Punues për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Janë zhvilluar zyrtarët ndërministrorë për barazi gjinore për shkëmbimin e përvojave dhe koordinimin e aktiviteteve për arritjen e barazisë gjinore në punësim dhe vendimmarrje, ku janë mbajtur takime me

zyrtaren për barazi gjinore në MAP ku jemi njoftuar në këtë takim për botimin e ligjit për barazi gjinore i cili ligj është shpërndarë tek zyrtarët e MAPL-së (60 kopje). Gjithashtu është mbajtur takimi me ZQM dhe zyrtarët e Ministrisë së linjës për promovimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, gjithashtu edhe në këtë takim janë shpërndarë ligji për mbrojtje nga diskriminimi të botuara nga ZQM-ja. Është mbajtur takim me zyrtaren për barazi gjinore të MMPH lidhur me shpërndarjen e ligjit për barazi gjinore për zyrtarët e MMPH-së. Po ashtu, MAPL ka realizuar edhe këto aktivitete, si vijon:

- MAPL ka mbledhur të dhënat dhe ka inkorporuar për raportin vjetor të komunave të Kosovës (2016);
- Është zhvilluar koordinimi i aktiviteteve me ministritë e linjës, ZQM/ZKM dhe komunat për përgjegjësitë e komunave për Zbatimin e Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuar (7 komuna) me ç'rast janë mbajtur dy takime me komunën e Drenasit, ky takim është zhvilluar në kuadër të projektit SoRi;
- Është bërë monitorimit i zbatimi të ligjit për përdorimin e gjuhëve – mbishkrimet, ku janë mbledhur të dhënat dhe janë inkorporuara në raportin vjetor të komunave të Kosovës (2016)
- MAPL ka dhënë mbështetje komunave në hartimin e planeve lokale për përfshirjen e komuniteteve RAE në shoqërinë kosovare (7 komuna) - Është mbajtur një takim me ZQM-në - DADNJK për koordinimin e aktiviteteve me komunat për PAK;
- Është hartuar letra rekomanduese për kryetarët e komunave për formimin e komitetit komunal operativ dhe emërtimin e zyrtarit komunal, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të strategjisë, si dhe është përcjellë;
- Është mbajtur takim me GP për hartimin e rregullores dhe Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të drejtat e fëmijëve;
- Janë mbajtur takime të rregullta me përfaqësuesit e projektit SoRi për realizimin, aktivitetet e projektit për vitin 2017. Në kuadër të këtij projekti është mbajtur trajnimi 3 ditor në Shkup me temën (Aplikimi i fondit IPA II).

Në fushën e bashkëpunimit me shoqërinë civile, MAPL gjatë kësaj periudhe i ka kushtuar rëndësi të veçantë, ku me datën 20 Janar 2017 ka shpallur thirrjen për projekt-propozime me qëllim të mbështetjes financiare të komunave, institucioneve të tjera dhe organizatave të shoqërisë civile. Financimi i projekteve është bërë në drejtim të avancimit të vetëqeverisjes lokale dhe fuqizimit të partneritetit ndërmjet tyre, si dhe zbatimit të objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Në këtë drejtim, është themeluar komisioni vlerësues *ad hoc* për vlerësimin e projekteve të propozuara. Në këtë fazë, janë mbështetur financiarisht 31 projekte, prej të cilave 27 OJQ , 2 projekte për komuna dhe 2 projekte për institucione të tjera të administratës publike. Vlera totale për financimin e 31 projekteve kap shumën prej 91,870.00 euro.

Në kuadër të aktiviteteve, MAPL ka marrë pjesë në takimin informues të organizuar nga MIE dhe GIZ me temë “Përfshirja e OSHC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në kuadër të strukturave të MSA-së”. Po ashtu, janë adresuar obligimet në procesin e liberalizimit të vizave dhe zbatimi i obligimeve të dala nga procesi i MSA-së dhe për këtë qëllim MAPL ka përgatitur matricat me identifikimin e çështjeve të cilat

kërkohen të ndërmerren nga komunat nga procesi i DPSA-së dhe PKZMSA. Lidhur me këtë, është përgatitur Matrica gjithëpërfshirëse për raportimin periodik të komunave. Periudha raportuese është përcaktuar të jetë 2 herë në vit, e gjithashtu janë përgatitur planet individuale për 38 komuna nga obligimet e agjendës evropiane për vitin 2017. Gjatë kësaj periudhe, është hartuar raporti vjetor i obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – dhjetor 2016. MAPL ka hartuar edhe analizën për shkallën e përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën janar - dhjetor 2016. Sipas raporteve, komunat kanë arritur të përmbushin 78% të aktiviteteve të parapara në fushën e kriterëve politike. Sa i përket kriterëve ekonomike, komunat kanë përmbushur 75% të aktiviteteve të parapara, ndërsa në fushën e standardeve evropiane, komunat kanë realizuar 68% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së kriterëve nga agjenda evropiane ka qenë 73%.

MAPL ka shënuar progres edhe në kuadër të zbatimit të programeve për bashkëpunim ndërkufitar, përkatësisht në programet: Kosovë – Shqipëri, Kosovë – Mal i Zi dhe Kosovë Maqedoni.

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Shqipëri është duke u realizuar projektin strategjik “Të ndërtojmë së bashku një rajon atraktiv dhe me prosperitet / Build Together an Attractive and Prosperous Region”. Ky projekt nga ana e Kosovës përfshin ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës ekzistuese nga fshati Krushevë deri në pikën kufitare në Shishtavec me gjatësi L=3.3 km, ndërtimin e parkingut afër pikës kufitare me sipërfaqe S=2000 m² instalimin e ndriçimit solar të parkingut dhe një pjesë e rrugës në hyrje të pikës kufitare si dhe furnizimi i pikës kufitare me energji elektrike ku përfshihet ndërtimi i linjës së tensionit të lartë dhe punimi i trafostacionit. Nga Zyra e BE-së në Kosovë, financohet 85% e projektit dhe përfshinë: ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës ekzistuese nga fshati Krushevë deri në pikën kufitare në Shishtavec me gjatësi L=3.3 km dhe ndërtimin e parkingut afër pikës kufitare me sipërfaqe S=2000 m². Për realizimin e punimeve Zyra e BE-së në Kosovë, ka kontraktuar kompaninë “RSM COMPANY sh.p.k”. Ndërsa për përgatitjen e dizajnit final të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve është kontraktuar kompania “InfraPlus”. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) financohet 15% e projektit dhe përfshinë: instalimin e ndriçimit solar të parkingut dhe një pjesë e rrugës në hyrje të pikës kufitare, si dhe furnizimi i pikës kufitare me energji elektrike ku përfshihet ndërtimi i linjës së tensionit të lartë dhe punimi i trafostacionit. Lidhur me realizimin e kësaj pjese të projektit, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes MAPL-së dhe Komunës së Dragashit me datë 28.06.2016, me ç’rast janë ndarë 200,000.00 Euro. Më pas Komuna e Dragashit për realizimin e projektit ka kontraktuar kompaninë “Eling”, e cila është duke realizuar punimet në terren.

MAPL ka shpallur thirrjen publike për projekt propozime më datën 11 janar 2017 lidhur me Programin IPA 2 BNK Kosovë-Shqipëri 2014-2020 e cila do të jetë e hapur deri më datën 16 mars 2017, respektivisht 45 ditë. Kurse, më datat 13-14 shkurt 2017 është mbajtur trajnimi 2 ditorë në Lezhë/Shqipëri, si dhe më datat 15-16 shkurt është mbajtur trajnimi 2 ditorë në Prizren/Kosovë, për aplikantët potencial. Veç kësaj, janë mbajtur 2 sesione informuese në Shqipëri (në Lezhë) më 1 shkurt 2017 dhe 2 shkurt në Kukës, si dhe dy sesione informuese në Kosovë, përkatësisht më 6 shkurt në Prizren dhe më 7 shkurt në Gjakovë. Ka filluar procesi i vlerësimit të projekteve, i cili bëhet nga delegacioni i BE-së në Tiranë.

Në kuadër të Programit IPA 1 BNK Kosovë-Maqedoni 2010-2013 – është duke u implementuar 1 nga 6 projektet e financuara nga thirrja për propozime, i cili planifikohet të përfundoj në muajin qershor 2017. Ky projekt realizohet në mes të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Tetovës. Projekti strategjik Shishtavec-Bellanovc parasheh ndërtimin e pikës së përbashkët kufitare në mes të Maqedonisë dhe Kosovës. Të gjitha procedurat dhe obligimet inicuese nga Qeveria e Republikës së Kosovës kanë përfunduar brenda afateve të përcaktuara. Ka vonesa nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për përmbushjen e obligimeve të tyre sa i përket procedurave të shpronësimit dhe dhënieve të lejeve përkatëse. Si rrjedhojë, afati i fundit i kontraktimit për ndërtim është data 24 gusht 2017, sipas marrëveshjes financiare. Në të kundërtën, rrezikohet që të humbin fondet në shumën prej 1.2 milion euro (600 mijë të Kosovës dhe 600 mijë të Maqedonisë) dhe për pasojë dështimin e tërësishëm të projektit. Kurse, me qëllim të mbylljes së thirrjeve dhe kontraktimit të projekteve nga IPA 2, MAPL së bashku me Ministrinë e Qeverisjes Lokale të Maqedonisë dhe zyrën e BE-së në Kosovë kanë përgatitur Udhëzuesin për aplikantë me qëllim të informimit të palëve dhe caktimit të kriterëve për thirrjen për propozime. Pas aprovimit të këtij udhëzuesi nga delegacioni i BE-së, pritet të shpalljet thirrja për propozime.

Në kuadër të programit IPA 1 BNK Kosovë-Mali i Zi 2011-2013, Janë duke u implementuar 8 nga 9 projektet e financuara nga Komisioni Evropian në vlerë të përgjithshme që kap shumën 3.2 milion euro. Një projekt ka përfunduar implementimin në shkurt të vitit 2017. Përveç kësaj është duke u përgatitur plani i monitorimit për monitorimin e projekteve, që do të implementohet gjatë muajit prill 2017. Po ashtu, Ministria e Financave e Malit të zi, në cilësinë e autoritetit kontraktues në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, ka hapur thirrjen publike për projekt propozime, të shpallur më datën 10 mars 2017. Afati i thirrjes vlen deri më datën 26 prill 2017, respektivisht 45 ditë. Në datat 28 shkurt - 2 mars është mbajtur trajnimi 3 ditorë në Rozhajë/Mal të Zi, si dhe më datat 7 deri 9 mars është mbajtur trajnimi 3 ditor në Pejë/Kosovë. Janë organizuar dy fushata informuese ditore dhe formuar për kërkimin e partnerëve (aplikantët potencial nga Kosova dhe Mali i Zi) për aplikim të përbashkët në projektet nga fondi i thirrjes. Ky aktivitet është realizuar më 27 shkurt 2017 në Rozhajë/Mal të zi dhe më 6 mars 2017 në Pejë/Kosovë. Gjithashtu janë organizuar dhe mbajtur 2 sesione informuese për aplikantët potencial në Mal të zi më 20 mars 2017, në Podgoricë në Bjelo Polje më 21 mars 2017, më 22 mars në Gjakovë/Kosovë dhe më 23 mars 2017 në Pejë Kosovë.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkombëtar, MAPL në vazhdimësi ka bërë monitorimin e zbatimit të ligjit dhe udhëzimit administrativ për BNK-n, është hartuar raporti vjetor dhe pritet publikimi i tij, si është organizuar punëtorja dy ditore me komuna lidhur me bashkëpunimin ndërkomunal.

Administrata dhe financat

Gjatë kësaj periudhe janë marrë supozimet për planifikim të mjeteve nga Menaxhmenti I lartë, është bërë dorëzimi I Kesh planit të parë në Ministri të Financave, është hapur petty cashi, janë mbledhur të dhënat lidhur me pasqyrat financiare, janë regjistruar pasuritë dhe stoqet për vitin 2016. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë përgatitur 3 flet alokime për Ministrinë e Financave, janë kompletuar lëndëet (tri pako) për

MeM dhe PIP, si dhe është bërë alokimi i mjeteve për 25 projekteve të para për vitin 2017. Totali i shpenzimeve për buxhetin e MAPL-së është 270,533.12 ose 5.45%. ndërsa, donacioni deri tani është shpenzuar 6,115.17 ose 6.03 %, si dhe raporti i realizmit të shpenzimeve së bashku me donacion është 5.47 %

Administrata në kuadër të MAPL ka qenë funksionale dhe në shërbim të institucionit të MAPL-së. Gjatë kësaj periudhe është ofruar ndihma në përkthim të materialeve, dokumenteve të ndryshme në gjuhën serbe dhe angleze, ka pasur në vazhdimësi lektorime të dokumenteve në gjuhë zyrtare, janë ofruar përkthim simulant në takime të ndryshme të cilat kanë i kanë zhvilluar njësitë e MAPL-së. Pastaj, janë ofruar shërbime në transport, shpërndarje të materialeve të ndryshme, fotokopje, janë ndihmuar komunat dhe stafi i MAPL-së përmes help-deskut, si dhe shërbime të tjera.

Sipas të dhëna në periudhën janar – mars, 2017 MAPL ka këtë strukturë të shërbyesve civil: 133 shërbyes civil, prej tyre 72 meshkuj dhe 61 femra. Sa i përket përbërjes etnike ato janë: 102 shqiptar, 29 serb dhe 2 turq.

MAPL, ka filluar zbatimin e planit të personelit për vitin 2017, janë iniciuar në vazhdimësi kërkesat për rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozita të lira, janë kompletuar dosjet lidhur me kërkesat inicuese për procedurat e rekrutimit për pozitat e lira në MAPL, si dhe është bërë njoftimi në faqen zyrtare të MAPL-së për përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm. Në vazhdimësi përditësohet baza elektronike me të dhëna për stafin e MAPL-së, po ashtu bëhet menaxhimi i udhëtimeve zyrtare, si dhe inventarizimi i dosjeve personale. MAPL koordinon aktivitet me IKAP-in sa i përket fushës së trajnime, gjithashtu ka koordinim edhe me Agjensionin Anti Korrupsion për sa i përket deklarimit të pasurisë.

Auditimi i brendshëm

Në fushën e auditimit, konform planit vjetor të punës për vitin 2016, ky sektor ka filluar me auditimet e vitit 2016, po ashtu janë realizuar edhe këto aktivitete, si vijon:

- Janë përfunduar dhe proceduar në kohën e paraparë raporti i TM4/2016 dhe Raporti Vjetor i punës së NJAB-it për vitin 2016.
- Raporti i TM1 do të hartohet dhe procedohet në Njësinë Qëndrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm dhe Menaxhmentit të lartë të MAPL-së në kohën e paraparë konform legjislacionit.
- Është dorëzuar Draft Raporti i Auditimit dhe pas afatit të dhënies së komenteve do të procedohet me kohë Raporti Final i cili do të përfshihet në raportimin e TM1.
- Është dorëzuar Draft Raporti i Auditimit dhe pas afatit të dhënies së komenteve do të procedohet me kohë Raporti Final i cili do të përfshihet në raportimin e TM1.

Gjatë kësaj periudhe me qëllim të komunikimit sa më të mirë me ZKA dhe ZKF, sipas kërkesave janë dhënë shërbime këshilluese - ZKA-së, ZKF-së dhe menaxherëve të tjerë, si dhe është mbajtur takimi i parë në vitin 2017 me KAB-in që ka përfshirë mbylljen e punës së vitit 2016.

Prokurimi

Gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2017 (janar – mars, 2017) edhe njësi e prokurimit ka zhvilluar aktivitet e saj. janë zhvilluar kontrata publike për furnizimet dhe shërbimet e prokurimit, të cilat janë pasqyruar në raportin tremujor të njësisë përkatëse. Prej 7 aktiviteteve të prokurimit, 2 janë tender, 2 janë kuotime të çmimeve, si dhe 3 janë kuotime të çmimeve me vlerë minimale (blerje minimale).